



Datë: 11.09.2025
Numër Protokolli: 6097/2025

A.nr.1073/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1073/2025, të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesi Sh.K, kundër organit të punësimit/Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike “*ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e filluar sipas ankesës me numër A.nr.1073/2025, të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesi Sh.K.

A r s y e t i m

Ankuesi, Sh.K (tutje referuar vetëm: *ankuesi*), më datë 04.06.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3774/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 642, të datës 12.05.2025, të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, me të cilin akt të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Rrjedhimisht, nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës, sikurse edhe bazës së të dhënave rezultoi se ankuesi, me datë 13.05.2024 ka parashtruar ankesë cila është regjistruar me numër A.nr.874/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularëve të vlerësimit të rezultateve të punës të vitit 2024, përkatësisht kundër formularëve të datës 26.02.2025 dhe datës 07.05.2025, mbi bazën e të cilave është nxjerrë Vendimi me numër protokolli 642, i datës 12.05.2025, i Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit.

Duke marr parasysh faktin se ankuesit përmes Vendimit me numër protokolli 642 të datës 12.05.2025, i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për arsye të dy vlerësimeve radhazi të pa papranueshme dhe se i njëjti kundër këtyre formularëve të vlerësimit të datës 26.02.2025 dhe 07.05.2025, me datë 13.05.2025 ka parashtruar ankesë në KPMSHCK, ndërsa Këshilli me Vendimin e datës 04.09.2025, ka vendosur për këtë çështje ankimore, ashtu që me këtë rast është aprovuar ankesa e ankuesit, si rrjedhojë formularët përkatës të vlerësimit të punës të ankuesit janë anuluar, ndërsa çështja është kthyer në rivendosje tek Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, rrjedhimisht ky i fundit është obliguar që të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin për vitin 2024.

Andaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se rivlerësimi i ankuesit për vitin 2024, nga Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, i obliguar sipas vendimit të ndërmjetëm A.nr.874/2025 të datës 04.09.2025 është parakusht për zgjidhjen e ankesës A.nr.1037/2025, të datës 04.06.2025, dhe se në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar parakushtet ligjore që të pezullohet kjo procedure administrative në kuptim të nenit 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që theksuar si me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1073/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Sh.K;
- Kryetarit të Komunës dhe Menaxheres së Personelit në Komunën e Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.